



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:272152

Datë: 25.11.2024

Numri i dokumentit: 06503108

C-III-12-0434

Ankuesit

R P, M K, N G, M B, Prizren

Kundër

E paditura

KBI “Progres Export” nga Prizreni e cila përfaqësohet nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rruga “Dritan Hoxha”, Lakrishte, nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), në Kolegjin e përbërë nga gjyqtarja Hajrie Shala kryesuese dhe anëtarët gjyqtarët Agron Hoxhaj dhe Asllan Krasniqi pas seancës vendimmarrëse të mbajtur 19 nëntor 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM
PËR MOSPARAQITJE

- 1. Padia hedhet poshtë.**
- 2. Nuk caktohen taksa gjyqësore .**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Paditësit në vitin 2006 kanë parashtruar padi në Gjykatën Komunale në Prizren kundër të paditurës KBI “Progres Export” nga Prizreni për kompensim të patundshmërie për NK nr., në sipërfaqe prej 0.56.04ha, sipas fletës poseduese nr.. ZK Prizren.

Paditësi në padi thekson se, pasi që nuk është e mundur t’i kthehet parcela kontestuese e theksuar si më lartë, si kompensim propozon që ti jepet në pronësi paluajtshmëria e ngastrës kadastrale nr. . në vendin e quajtur “..”, arë e klasit të dytë e evidentuar në fletën poseduese nr.. ZK D.

Sipas aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Prizren nr. P.br.657/98 të dt. 14.04.2003, në pikën 2 të dispozitivit të këtij aktgjykimi, kërkesëpapia e paditësve për anulimin e kontratës mbi ndërrimin me nr. Ov.br... të dt. e lidhur në mes të H I L me të paditurën për ngastrën kontestuese nr.. në sipërfaqe prej 0.56,04ha refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata Komunale në Prizren me aktvendimin C.nr.564/06 të dt. 29.08.2011 shpallet jo kompetente dhe lëndën e delegon në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme.

Me 06 mars 2015, e paditura AKP parashtron mbrojtjen e saj me të cilën thekson se e kundërshton padinë dhe pretendimet paditore të paditësve si të pa bazuara. Andaj, propozon Dhomën që të hedh padinë si të pa pranueshme ose ta refuzoj si të pa bazuar në ligj.

Gjykata ka tentuar të dërgoj mbrojtjen tek palët paditëse, por në zarfin e kthyer figuron konstatimi si “Refuzim, pala gjendet në Turqi”.

Me dt. 19 nëntor 2024, gjykata ka caktuar seancë dëgjimore. Në ftesën për seancë është kthyer zarfi me mbishkrimin “Larguar – Marrësi gjendet në Turqi”. Pas dështimit të dorëzimit – pranimit të ftesës, gjykata duke u bazuar në nenin 26, par.5 të Ligjit nr.06/L-086 të ligjit për Dhomën e Posaçme dhe nenit 116.5 dhe 116.6 të LPK-së ka publikuar në tabelën e shpalljes ftesën prej dt. 21.10.2024-19.10.2024.

Në seancën e mbajtur më 19.11.2024, nuk u paraqitën asnjë nga paditësit e as përfaqësuesi i tyre – ndërsa përfaqësuesja e AKP-së V H pas konstatimeve të bëra deklaroj se në mungesë të interesit juridik i cili është i domosdoshëm me qëllim të gjykimit të plotë dhe të sakt të çështjes dhe meqë palët paditëse nuk prezantojnë në seancë përkundër të gjitha përpjekjeve i propozon gjykatës që papia të konsiderohet e tërhequr nga paditësit ose në të kundërtën të merret aktgjykim për mos paraqitje.

Arsyetimi Ligjor

Papia hedhet poshtë

Sipas nenit, 58.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme parashihet: *“Nëse parashtruesi i ftuar sipas rregullit nuk paraqitet në seancë dëgjimore apo nëse braktis procedurat, atëherë gjyqtari(ët) gjegjës, mund pas parashtrimi të kërkesës nga pala kundërshtare, të nxjerrë një Aktgjykim për*

mosparaqitje kundër Parashtruesit duke hedhur poshtë kërkesën dhe duke urdhëruar Parashtruesin që të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale”.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seanca gjyqësore në mënyrë që ankuesëve përmes përfaqësuesit të tyre ti qartësojnë kërkesat e tyre, ngase përmes parashtrësave nuk kanë arritur të bëjnë të qarta kërkesat. Mirëpo, përkundër faktit se të njëjtit janë ftuar në mënyrë të rregullt, nuk është arrit që të njëjtit të sigurohen për seanca. Gjykata ka përsëritur ftesat dhe ka publikuar ftesën edhe në tabelën e shpalljes mirëpo, paditësit R P, M K, N G dhe M B edhe pse janë ftuar në mënyrë të rregullt për seancën dëgjimore të caktuar për datën 19 nëntor 2024 të njëjti nuk i janë përgjegj ftesës së gjykatës, andaj, sipas propozimit të përfaqësuesit të paditurës që të mirret Aktgjykim në mungesë, Gjykata aprovoi të njëjtin duke gjetur se janë përmbushur kushtet e parapara në kuptim të nenit 58.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Andaj nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 58.2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme , u vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet gjyqësore

Secila palë i bartë shpenzimet e veta.

Këshillë juridike

Në pajtim me nenin 59 të Ligjit për Dhomën e posaçme, cilado palë mund të parashtrojë një kërkesë në DHPGJS për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje.

Kërkesa për prishjen e aktgjykimit për mosparaqitje duhet të parashtrohet brenda 1 (një) muaji nga dita e dorëzimit të aktgjykimit për mosparaqitje te pala gjegjëse.

Hajrie Shala, Kryesuese _____

Asllan Krasniqi, Gjyqtar _____

Agron Hoxhaj, Gjyqtar _____